



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



02/Nr. 559
Data: 20.01.2023

PROCESVERBAL I RAPORTIT TË PUNËS SË KRYETARIT PËR VITIN 2022

Procesverbali nga Raporti i punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022, të mbajtur me datën 21.12.2022, duke filluar nga ora 16:00 në Sallën e Takimeve në katin I në objektin e Komunës me gjithsej 34 pjesëmarrës/e. Për prezentimin e Raportit, prezent ishte **Mehmet Ballazhi** (Kryetari i Komunës), **Arsim Dernjani** (Drejtor për Shërbime Publike dhe Emergjencë), **Abduraman Bushi** (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural), **Natyra Kalisi** (Drejtoreshë e Administratës së Përgjithshme), **Lindita Ballazhi** (Drejtoreshë për Buxhet dhe Financa), **Nexhmedin Daci** (Drejtor përbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit), **Kimete Kuka-Hasallari** (Drejtoreshë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale), **Majlinda Kaloshi** (Drejtoreshë për Zhvillim Ekonomik) dhe **Hisni Luri** (Drejtor për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport), nga Kabineti, zyrtarë të drejtorive përkatëse, si dhe qytetarë nga Hani i Elezit me rrethinë.

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës z. **Mehmet Ballazhi**, i cili iu uroi mirëseardhje të pranishmëve që kishin gjetur kohë për të ardhur në dëgjimin publik mbi raportin e punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022 dhe theksoi se ky raport do të prezentohej shkurtimisht nga ai pasi që materiali i plotë ishte shpërndarë te të pranishmit, dhe për të plotësuar do të jenë të gatshëm drejtorët/et komunale.

Me këtë rast, Kryetari falënderoi në veçanti zyrtarët komunalë që kanë qenë të drejtëpërdrejtë në kryerjen e punëve duke arritur rezultate, si pasojë e bashkëpunimit të mirë mes stafit ekzekutiv dhe stafit civil.

RENDI I PUNËS

1. Raporti i punës së Kryetarit të Komunës së Hanit të Elezit për vitin 2022

Mehmet Ballazhi thekson: Ky raport fillon me realizimin e parë, duke vendosur ndarje të barabartë gjinore në udhëheqje të drejtorive, ku është arritur 50/50. Janë proceduar shujtat për nëpunësit civilë të administratës komunale dhe zjarrëfikësit për vitin 2021, si dhe janë ndarë afër 172 mijë € për ekzekutimin e kontratave kolektive për vitet 2018, 2019 dhe 2020. Jemi mundu që të realizojmë shujtat e administratës edhe për vitet e kaluara që nuk i kanë marrë, por nuk e dimë se a do të pranojë niveli qendror, këto dy ditë të fundit, megjithatë ne e kemi vullnetin dhe e kemi kry punën tonë, tash tjetër kush e ka në dorë se a kanë vullnet apo jo niveli qendror ta realizojë propozimin tonë, për të cilin kam nxjerrë edhe vendim për realizimin e shujtave të administratës. Kemi kryer obligime dhe borxhe nga vitit 2016 deri në vitin 2021 në vlerë prej 228,667.13 €. Kemi rritur numrin e dëgjimeve buxhetore, ku për herë të parë kemi realizu dëgjim të veçantë buxhetor për Handikos dhe për gratë, e poashtu kemi mbajtur dëgjime edhe në fshatrat, pra gjithsej 11 dëgjime për KAB-in dhe Draft Buxhetin. Buxheti për vitin 2022 ka qenë në vlerë prej 2,759,758.00 €, prej tyre 455 mijë € dhe janë shpenzuar rreth 88.7%, kurse të hyrat direkte që i kemi inkasuar janë 82%, ku nga viti i kaluar prej 280 mijë €, janë rritur mbi 100 mijë € për vitin 2022, pra në 380 mijë

€ për vitin 2022 ku prej tyre kemi arritur t'i inkasojmë rreth 82%, rritja mes viteve është e papranueshme, ne kemi bërë kërkesë që me na u zvogëlu planifikimet e të hyrave, sepse jemi komunë e vogël, megjithatë kemi arritur t'ia dalim mjaft mirë. Kemi arritur 20 marrëveshje, me shkrim, me gojë dhe me marrëveshje, të cilat janë: 1)Marrëveshje me Komandën e Jugut për aktin e donacionit të furnizimit me panele solare pranë komunës së Hanit të Elezit; 2)Komuna e Hanit të Elezit nënshkruan Memorandum Mirëkuptimi me Organizatën Kosovare për Talent dhe Arsim – TOKA; 3)Marrëveshje për shërbime të ujësjellsit dhe ujërave të ndotura në mes të Komunës së Hanit të Elezit dhe KRU "Bifurkacioni" SH.A.; 4)Marrëveshje për depozitim të mbetjeve inerte të krijuara nga Komuna Hani i Elezit si një material i mbushjes së pasme në guroren e Dimcës; 5)Memorandum Bashkëpunimi mes Komunës Hani i Elezit dhe komunës shqiptare nga Maqedonia e Veriut, Komunës së Tearcës; 6)Memorandum bashkëpunimi Komuna Hani i Elezit me organizatë YIHR KS.; 7)Marrëveshje bashkëpunimi Komuna e Hanit të Elezit dhe Caritas-i Zvicërian për projektin “Ndikimi i Rinisë në Mjedis” (YENI).; 8)Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Hanit të Elezit dhe MAPL.; 9)Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komunës Hani i Elezit dhe Universitetit të Shkencave të Aplikuara, Ferizaj. 10)Marrëveshja mes Komunës Hani i Elezit dhe Qeverisë së Kosovës për “Kartën e Gjellbërt”. 11)Marrëveshje bashkëpunimi mes Komunës Hani i Elezit dhe Illyrian shpk për platformën digjitale eShkollori. 12)Marrëveshje me Agjencinë Kadastrale të Kosovës për Kompletimin e Sistemit të Adresave në Territorin e Komunës.; 13)Marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e manifestimit tradicional Eksodi “Bllaca 99”. 14)Marrëveshje mirëkuptimit me MMPHI për “Rregullimi i parkut në rrugën “Isa Berisha””, bashkëfinancim me komunën.; 15)Marrëveshje me MMPHI për asfaltimin e rrugës Paldenicë – Ramukë, rreth 213 mijë €. 16)Marrëveshje bashkëfinancimi me MAPL për “Shtrimi me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe Fshatrat përreth”. 17)Marrëveshje me Unëomen për Buxhetimin e përgjegjshëm gjinor. 18)Marrëveshje me Ambasadën e Japonisë në Kosovë për projektin e Urës në Seçishtë.; 19)Marrëveshje për Shërbime të Energjisë me Fondin e Kosovës për Eficiencën e Energjisë. 20)Marrëveshje mirëkuptimi për lirim të hapsirës për demolimin e strukturave ekzistuese në afërsi të Lumit Lepenc. Kemi hartuar 12 projekte: Hartimi i projektit të rrugës Krivenik-Gorancë, Hartimi i projektit fazës finale të Qendrës Kulturore të Rinisë, Hartimi i projektit të asfaltimit të rrugës Ramuka-Paldenicë, Hartimi i projektit të kanalit të hapur në fshatin Paldenicë (IPA fondet), Hartimi i projektit të mureve mbrojtëse, Hartimi i projektit të Parkut të Qytetit “Isa Berisha”, Hartimi i projektit të rregullimit të hapësirave përreth Komunës, Hartimi i projektit të urës shtesë të ura e Seqishtës, Hartimi i projektit të vendosjes ashensorit në objektin e Komunës, Hartimi i projektit të shtrimit me kubëza të rrugicave në zonat urbane dhe rurale, Hartimi i projektit të projektit tek Bllaca 99, Projekti për vendosjen e paneleve solare në objektet publike komunale etj. Janë ndarë bursa për 45 studentë në vlerë në 22,500.00 €, ku 30 bursa janë financim nga komuna dhe 15 nga bizneset që operojnë në Hanin e Elezit. Janë ndarë subvencione për grurë, serra tunel dhe bletari në vlerë prej 10,182.50€. Janë ndarë subvencione në fushën e Sportit, Kulturës dhe Rinisë në vlerë prej 23,000.00€. Janë ndarë subvencione nga Kryetari i Komunës për rehabilitimin në banjë të personave me nevoja të veçanta, familjeve të dëshmorëve, pensionistëve. Janë ndarë 133 pagesa për lehonit në vlerë rreth 13,300.00€ dhe pjesa tjetër subvencione për familje me nevoja sociale për ndihmesë ekonomike dhe rreth 5 student për studime jashtë vendit në Vendet Evropiane. Kemi investuar në digjitalizim shkollave, në rregullimin e infrastrukturës në shfmu “Ilaz Thaçi” paralelja në Seçishtë duke rregulluar banjot, është bërë rregullimi i parkingut dhe janë vendosur rrethoja përreth sallës së sportit tek shfmu “Veli Ballazhi” në Gorancë, është bërë rregullimi i shkallëve të hyrjes dhe korsia për nxënës me nevoja të veçanta, ndriçimi i shkollës me LED dhe lidhja e Aneksit të shkollës duke krijuar edhe një kabinet për histori dhe gjeografi në shfmu “Kështjella e Diturisë” në Paldenicë. Janë zhvilluar gara shkollore, insituacionale në futboll, atletikë, pinpong, volejball, së bashku me shoqatën e pedagogëve. Është bërë impelmentimi i fazës finale të Shtëpisë së Kulturës në vlerë prej 270 mijë €, si dhe është bërë hartimi i Rregullores për administrimin

e Shtëpisë së Kulturës, dhe është bërë Raporti hulumtues për Puset e Nikës. Kemi financuar projektin “Komuna për të Rinjtë” për 5 përfitues nga Hani i Elezit, në vlerë prej 3500 €. Kemi ndryshuar Rregulloren për subvencionet, kemi shtuar +10 bursa edhe për studentët e Universiteteve të rajonit. Kemi dhënë në shfrytëzim zyret e Qendrës Kulturore për OJQ të ndryshme lokale. Kemi funksionalizuar Kabinetin e Informatikës në shfmu “Veli Ballazhi”. Kemi realizuar pozitën e psikologut shkollor. Kemi dërguar për studime të mëtutjeshme të gjimnazit në Turqi 5 nxënës të dalluar. Kemi renovuar dhe funksionalizuar AMF në Gorancë, është kompletuar procedura e funksionalizimit të sektorit të Stomatologjisë, kemi asgjësuar 2200 kg barna me afat të skaduar që na ka kushtuar në vlerë prej 7200€, si dhe janë shpërndarë 300 pako për familje në nevojë. Kemi fituar grant për shtrimin me kubëza betoni të rrugicave dhe trotuareve në Han të Elezit dhe fshatrat në vlerë prej 30 mijë €. Kemi fituar grant nga Qeveria Japoneze për renovimin e urës së Seçishtës në vlerë prej 44 mijë €. Kemi organizuar Panairin Tradicional për prodhime bujqësore, kulinari dhe artizanale. Kemi zhvilluar trajnime për njohuri bazike në software për gratë dhe vajzat. Kemi hartuar projektin për ndërtimin e parkut memorial Bllaca 99 në vlerë prej 100 mijë €, gjithashtu edhe parku “Isa Berisha” në vlerë prej 256 mijë €. Kemi vendosur rrethoja tek përroi në Lagje të Re. Kanë filluar punimet për asfaltimin e rrugës Paldenicë-Ramukë në vlerë prej 213 mijë €, si dhe janë shtruar rrugë në zona urbane dhe rurale me kubëza betoni në vlerë prej 55 mijë €. Kemi bërë gjelbërimin e hapësirave publike në vlerë prej 14 mijë €. Kemi bërë rregullimin e kanalizimeve atmosferike në zonat urbane dhe rurale në vlerë prej 23 mijë €. Kemi vendosur tabela digjitale në rrugën “Adem Jashari”, te objekti i komunës, te QKMF dhe AMF. Kemi bërë shenjëzimin për personat me aftësi të kufizuara në parkingjet përreth komunës. Kemi ndërtuar dhomën për klorizimin e ujit të pijes dhe pompën për filtrimin e ujit në burimin e vjetër të ujit të pijet në Gorancë, donacion nga fabrika Sharrcem në shumë prej 10 mijë €. Janë vendosur 350 ujëmatës në Han të Elezit dhe 200 ujëmatës në Gorancë. Është bërë eliminimi i deponive ilegale të mbeturinave, si dhe freskimi i rrugëve gjatë verës, dhe pastrimi i shpeshtë i borës gjatë dimrit. Është bërë subvencionimi i 45 fermerëve në vlerë prej 10,182.00€. Janë vendosur kontenjerët apo shtëpizat për nevojat e rojeve të pyjeve. Te Gjendja Civile është ofruar shërbim për bashkëatdhetarët gjatë pushimeve verore dhe dimërore edhe gjatë pauzave dhe fundjavave. Është bërë organizimi i trajnimeve për zyrtarë me tema të ndryshme si vendimarrja menaxheriale, procedurat administrative, ligji i zyrtarëve civilë, etj. Kemi formuar Këshillat e Fshatrave dhe Vendbanimeve, si dhe janë zgjedhur 4 administratorë të tyre. Është bërë funksionalizimi i e-Pasurisë, e cila për vite me radhë ka qenë e gjetur dhe e rekomanduar nga auditorët. Dhe në fund, nga krejt kjo ka rezultu me fitimin e një çmimi ndërkombëtar i vlerëuar nga Këshilli i Evropës dhe organizata ALDA, pra jemi shpërbly me Çmimin Evropian i Qeverisjes së Shkëlqyer. Faleminderit për vëmendjen tuaj! Tani, unë do të ju kisha lutur që edhe ju t'i bashkangjiteni këtij debati publik, të na jepni vërejtjet dhe këshillat tuaja, me qëllim që ne të mund të përmirësohemi në vitin e ardhshëm qeverisës. E hap diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Visar Hasallari (përfaqësues i KVRL-së): Ne mbështesim iniciativat e mira të qeverisjes lokale që 1% i kemi si të përbashkëta, si feminizmi dhe përfaqësimi gjinor 50/50; një falënderim drejtorit të DKA-së për realizimin e shtimit të numrit të bursave edhe për studentët e Universiteteve Rajonale pra për ndryshimin e Rregullores për ndarjen e bursave; gjithashtu falënderim edhe për përfshirjen e psikologut shkollor; përveç lëvdave kemi edhe disa kritika që na i kanë përcjellë nga Këshilli Qendror i KVRL-së, si psh ndarja e çmimit Qytetar Nderi që është në kundërshtim me Statutin e Komunës; organizata jonë e ka dhanë edhe një prononcim publik për KTV-në, ku kemi thënë se s'jemi kundër shtrimit të rrugëve, siç është ndarë buxhet për shtrimin e rrugës te Lagja Ballazhi në Pusteni, por ne kemi thënë se ato mjete në vlerë prej 58 mijë € do të kishte qenë mirë me u nda për ujin e pijes, si dhe te marrëveshja numër 4 nuk e kam të qartë, pra për depozitimin e mbetjeve inerte.

Mehmet Ballazhi: Për pyetjen e fundit, ne kemi një marrëveshje me Sharrcemin që të gjitha mbetjet inerte të derdhen te kjo gropa që është shfrytëzu për to mbrapa Shell-it dhe ne përmes kompanisë NPL Pastrimi ju kemi bërë thirrje të gjithëve që kushdo që ka diçka materiale të tilla, të gjuhen aty me ndihmën e NPL Pastrimit. Sa i përket pyetjes tjetër për ndarjen e Qytetar Nderi, dua të ju njoftoj se atë çmim që ua kam dhanë musfairëve që kanë dhënë mund në Han të Elezit, unë nuk kam nxjerrë as vendim dhe as ndonjë dokument tjetër me protokol zyrtar komunal, pra nuk ka asnjë efekt juridik, dhe është e drejta ime që përderisa nuk bëj shkelje me protokol, të ndaj çmime të ndryshme si lloj mirënjohje. Kurse për te rruga në Pustenic, unë kam dhanë deklaratat te mediat, dhe ju njoftoj se për atë rrugë është bërë kërkesë prej 2018, dhe ai projekt është në vazhdimësi të projekteve të shtrimit të rrugëve, dhe te ajo rrugë nuk kanë qasje vetëm familja Ballazhi, por fillimisht kanë qasje Familja Brava që kanë shtallën e poashtu edhe të tjerë ku kanë pronat. Te ajo rrugë përveç këtyre, është lagje ku është një familje e dëshmorit, gjithashtu bletarë dhe veprimtari të tjera bujqësore, e poashtu është edhe një burim i ujit ku furnizohet me ujë kompleksi memorial i varrezave të dëshmorëve, do të thotë nuk është projekt që nuk ia vlen apo se ato mjete kanë ma shumë rëndësi me u investu te ujit, sepse për çështjen e ujit folëm më sipër se çka është bërë deri tani.

Vait Daci: Ju përgëzoj për punët e realizuara, dhe ju kisha sugjeru edhe një herë që të shfrytëzoni autoritetin tuaj maksimal për realizimin e shujtave të administratës, sepse na detyrohemi të shkojmë përmes gjykata siç kanë vepru mësuesit. Si dhe e dyta, te ndarja e subvencionimit për në banjë që e keni bo, nuk e kam të qartë kush e ka bo përzgjedhjen dhe ju kisha propozu që nëse prapë subvencionohen penzionerët, të përfshihen edhe gratë penzionere.

Mehmet Ballazhi: Fillimisht, te çështja e penzionerëve, përzgjedhjen e kanë bërë vet kryesia e shoqatës, ata fillimisht kanë parashtru kërkesë te ne, ne pasi e kemi shqyrtu kemi marrë vendim të subvencionohen me një shumë të caktuar, por përzgjedhjen e kanë bërë vet shoqata, e nuk ka aps asnjë ndikim dhe e kuptoj propozimin tënd, dhe pajtohem me ty, por nuk e shoh të arsyeshme ndërhyrjen time në përzgjedhje. Kurse për te shujtat, jeni të njoftuar se ne veçse kemi shprehur vullnetin e plotë për ekzekutimin e shujtave, dhe kam zhvillu takime në Ministri edhe me Drejtorin e Thesarit të Kosovës, ja kam shprehur se ne kemi vullnet dhe duam t'i realizojmë, megjithatë nuk është në dorën tonë, dhe po presim edhe këto dy ditë, nëse ata vendosin të na i ekzekutojnë apo jo. Megjithatë vullnetin e kam pasur që në fillim, ashtu siç edhe i kemi realizuar për vitin 2021, por tani po presim.

Mehmet Ballazhi: A keni edhe ndonjë diskutim për Raportin që u prezentua sot? Nëse nuk ka, e shpall të mbyllur Debatin publik.

Mbledhja përfundoi në ora 16:51

Procesmbajtësja
Liridona Ballazhi



Kryetari i Komunës
Mehmet Ballazhi

